

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE
VLORE

Nr.Regj.Them 615
Dt.Regj 18.02.2016

Nr. 433 . Vendimi
Datë 31.03.2016

V E N D I M

“Në emër të Republikës”

Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Vlore, e përbërë prej :

Gjyqtar- Astrit Shema

asistuar prej sekretares gjyqesore **Anila Rista**, në Vlore, sot më datë 31.03.2016 përfundoj së shqyrtuari në seancë gjyqesore publike çështjen civile me Nr. 615. Regj.Them, date paraqitje 18.02.2016, që i përket paleve ndërgjyqese :

Paditës : Shpresa Guri, përfaqësuese ligjore e subjektit Bar-Kafe, me NIPT L43727402K, ne Lagjen “Clirimi”, Rr. Qemal Stafa, pallati nr.18 Lushnje. (Ne mungese ne shpalljen e vendimit).

I paditur: Drejtoria Rajonale Tatimore Vlore, përfaqësuar me autorizim e datës 07.03.2016 me nr 4860/1 prot, prej juristes Ervisa Shabani.

Drejtoria e Apelimit Tatimor, përfaqësuar ne gjykim me autorizim 07.03.2016 me nr 4860/1 prot, prej juristes Ervisa Shabani.

Objekti: Kundërshtim Njoftim Vlerësimi për Detyrimet nr.25410 dt.14.12.2015 te Drejtorisë Rajonale Tatimore Feir, vetëm për gjobën ne vlerën 50.000 leke, lëne ne fuqi me Vendimin nr.42336/1dt.12.02.2016 te Drejtorisë se Apelimit Tatimor

Baza ligjore: Neni 31,32,153, e vijues dhe 324 e vijue ste K.Pr. Civile, Kodi i procedurave Administrative, Ligji nr.9920/2008 “Per Procedurat Tatimore ne R.Sh” i ndryshuar, ligji nr.49/2012 “Per Organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe mosmarrveshjeve administrative”.

Gjykata pasi mori provat e nevojeshme, degjoi ne kerkimet perfundimtare palen paditese ne proces e cila u shpreh : Per pranimin e padisë,

Perfaqesuesi i pales se paditur-Drejtoria Rajonale Tatimore ne kerkimin e saj perfundimtar u shpreh :-Per rrezimin e padise;-Drejtoria e Apelimit Tatimor Tirane-nepermjet prapesimeve te saj ka kerkuar : rrezimin e padise;si e analizoi ceshtjen ne teresine e saj :

V Ë R E N:

Paditësia i është drejtuar gjykatës me anën e padisë së mësipërme duke kerkuar sipas objektit te padise.

Përpara shqyrtimit të bazueshmërisë në ligj e në prova të kërkesës, gjykata mori ne shqyrtim dhe analizoi fillimisht juridiksionin dhe kompetencën e saj në gjykimin e kësaj çështje.

Ne lidhje me kete fakt gjykata ju referua ligjit me nr.49/2012 “Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarreshjeve administrative “KREUT III te saj (nenit 7,pika b) e saj)/kompetenca lendore/ ne te cilin midis te tjerash citohet se :

Gjykatat administrative jane kompetente per : :”. *Gjykatat administrative janë kompetente për:*

a) *mosmarrëveshjet që lindin nga aktet administrative individuale, aktet nënligjore normative dhe kontratat administrative publike, të nxjerra gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative nga organi publik;duke gene se ndodhemi perpara nje mosmarreshje me karakter administrativ qe rrjedh nga marrëdhëniet civile mes paleve ndergjyqese”, çmoi kryesisht se çështja e paraqitur eshte ne juridiksionin lendor te kesaj gjykate.*

“Gjithashtu ne reference te nenit 10 te ligit te mesipercituar”Kompetenca funksionale” ne te cilin citohet se :” 1. Gjykata administrative e shkallës së parë shqyrton mosmarrëveshjet administrative të parashikuara në nenin 7 të këtij ligji, me përjashtim të atyre që lidhen me aktin nënligjor normative,arriti ne kunkludimin se kjo çështje eshte nen kompetencen funksionale te kesaj gjykate.

Ne lidhje me competence tokesore kjo gjykate j’u referuar nejit 11 te ligjit me nr. 49/20012”Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” ne te cilin citohet se “1. *Paditë kundër veprimit administrativ shqyrtohen në gjykatën administrative të shkallës së parë, që përfshin territorin, në të cilin organi publik ka kryer veprimin administrativ që kundërshtohet. Në rastet kur organi administrativ më i lartë, pas ankimit administrativ, e ndryshon aktin administrativ të organit vartës, padija ngrihet në gjykatën që përfshin territorin ku ka qendrën organi administrativ më i lartë.*

Gjithashtu Gjykata, në vështrim të neneve 12 te ligjit te mesipercituar, çmoi çështje duhet gjykuar me nje gjyqtar te vetem.

Rrethanat e faktit.

Ne përfundim te shqyrtimit gjyqësor rezultoj se paditesja Shpresa Guri, Person Fizik, me adrese ne lagjen “Clirimi, Rr, Qemal Stafa, pallati nr.18 Lushnje, me NIPT L43727402K me object kryesor te ushtrimit te aktivitetit BAR-KAFE, ne daten 13.09.2015 I eshte ushtruar kontroll nga Inspektoret e Drejtorise Rajonale Tatimore Fier, date ne te cilen eshte mbajtur dhe Akt Konstatimi me nr. Serial 0529613 dt.13.09.2015, ne te cilin konstatohet se subjekti nuk eshte i paisur me deftese tatimore, e cila zvendeson kuponin tatimor per shitjet me leke ne dore deri ne

momentin e instalimit te paisjese fiskale. Ne baze te ketij konstatimi, inspektoret e DRT Fier kane mbajtur Proces –Verbalin e Gjebes me nr.serial 0179160 dt.13.09.2015, nepermjet se cilit tatimpaguesi Shpresa Guri penalizohet conform nenit nr.122/b te Ligjit nr.9920 “Per Procedurat Tatimore ne R.Sh” I ndryshuar, me gjobe 50.000 leke. Bazuar ne Akt Konstatimin me nr. Serial 0529613 dt.13.09.2015, dhe ne Proces –Verbalin e Gjebes me nr.serial 0179160 dt.13.09.2015 inspektoret e Drejtorise se Vleresimit te Vleresimit te te Ardhurave tatimore dhe Kontabilitetit prane DRT Fier kane nxjerr “Njoftim Vleresimin per Detyrimet” me nr.25410 dt.14.12.2015 per gjobe per mosleshim deftese tatimore per shitje me leke ne dore.

Me Njoftim Vleresimi nr. 25410 dt.14.12.2015 tatimpaguesi “Shpresa Guri” nuk ka gene dakort dhe per kete arsye e ka ankimuar prane Drejtorise se Apelimit Tatimor ne Tirane.

Drejtoria e Apelimit Tatimor Tirane pasi e ka marre ne shqyrtim ankimimin e tatimpaguesi “Shpresa Guri”, me shkresen nr.42336/1 dt.12.02.2016 ka vendosur : “Lenien ne fuqi te Njoftim Vleresimit per Detyrimet me nr. 25410 dt.14.12.2015”.

Me pas subjekti “Shpresa Guri”me NIPT L43727402K i eshte drejtuar gjykates me objekt: “Kundershtim Njoftim Vleresimi per Detyrimet nr.25410 dt.14.12.2015 te Drejtorise Rajonale Tatimore Feir, vetem per gjoben ne vleren 50.000 leke, lene ne fuqi me Vendimin nr.42336/1 dt.12.02.2016 te Drejtorise se Apelimit Tatimor”

Parashtrimet e palës paditëse;

Paditesja Shpresa Guri pretendon se : Ushtron aktivitet Bar Kafe me nr. L43727402 K ne qytetin e Lushnjes, nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, me date 14.12.2015 vihem ne dijeni te, Njoftim Vleresimi per Detyrimet nr.25410Prot, se Detyrime te pashlyera biznesi im i vogel Bar-Kafe NIPT L43727402K, nuk ka, por ka nie gjobe ne vleren e 50.000 (pesedhjetemijeUekeve, me arsye: "Mos leshim deftese per shitje me lek ne dore PVGJ 0179460".

Gjobe te cilen une e konsideroj te pamotivuar sipas ligjit nr. 9920, date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar.

Per kete fakt , une ju drejtova dhe kerkova nga Drejtoria e Apelimit Tatimor, prane Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve, anullimin e gjobes , por Drejtoria e Apelimit Tatimor me shkresen me nr.42336/lprot date 12.02.2016 , me kthen pergjigje se ka vendosur ; -"Lenien ne fuqi te aktit objekt ankimi administrativ, Njoftim vleresimi per detyrimet tatimore .25410proL, date 14.12.2015, te Drejtorise Rajonale Tatimore Fier, gjobe ne vleren e 50 000 lekeve.

Per keto akte te Drejtorise Rajonale Tatimore Fier dhe te Drejtorise se Apelimit Tatimor , une si biznes nuk jam dakort, me keto arsye si me poshte:

Aktiviteti qe une ushtroj , ku punoj se bashku me bashkeshortin tim, eshte Bar-kafe me siperfaqe lokali prej 10 m2 ne total, ku brenda jane gjithsesj 3 tavolina me kater karrige , ne total ne dite mesatarisht ne bejme nje xhiro rreth 1000 leke/dita, pasi vetem kafe , raki dhe caj shesim kryesisht.

Per cdo shitje une i pajisja klientat me Deftese Tatimore, duke ju vene ne dispozicion edhe kopje te Bllokut per Deftesat tatimore qe leshoj ne biznesin tim , cdo klienti.

Gjithashtu, une bera pagesen prane Bankes Credins ne date 29.08.2015 per te blere Kasen Fiskale dhe gjate kohes qe nuk me kishte ardhur kasa, punoja me Deftesa tatimore shitje. Me keto te ardhura ne si bashkeshorte , mbajme dhe ushqejme familjen se bashku me dy vajzat , duke qene te rregullt, persa i perket shlyerjeve te detyrime tatimore , fakt qe e tregon edhe vet Njoftim Vleresimi I DRT Fier.

Vendosja e nje gjobe te tille per biznesin tim do te thote qe une ta mbyll ate **padi nuk** kam asnje mundesi finnaciare dhe te ardhur tjeter.

Si perfundimi paditesja kerkon: “Pranlmin e kerkese padise.Kundershtim Njoftimit Vleresimit per Detyrimet Tatimore Nr.25410prot date 14.12.2015 te Drejtorise Rajonale Tatimore Fier, per gjoben ne vleren e 50.000(pesedhjetemije) lekeve, lene ne fuqi me vendimin nr.42336/lprot date 12.02.2016 te Drejtorise se Apelimit Tatimor, prane Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve”.

Prapesimet e Drejtorise Rajonale te tatimeve Vlore:

Nga verifikimi i provave materiale te ndodhura prane Drejtorise Rajonale Tatimore Fier, rezulton se akti Administrativ Njoftim Vleresim nr. 25410 dt.14.12.2015 eshte tersisht ligjor, konform formes dhe procedures se kerkuar nga ligji procedural dhe ai material.

Kundershtimi i subjektit ne lidhje me Aktin Administrativ te sipercituar nuk ka baze ligjore pasi Akt –Konstatim nr. Serial 0529613 dt.13.09.2015 dhe Proces –Verbali i Gjebes me nr.serial 0179160 dt.13.09.2015 jane teresisht conform ligjit, keshtu kontrolli I ushtruar ne tatimpaguesin Shpresa Guri, nga inspektoret e DRT Fier, eshte bere ne baze te Urdherit te Punes me nr.12618 dt.13.09.2015. Ne akt konststatim thuhet se subjekti ka kryer pagesen per instalimin e paisjes fiskale ne daten 29.08.2015 por nuk eshte I paisur me Deftese Tatimore, dokumenti I cili zvendeson kuponin tatimor per shitjet me leke ne dore, deri ne momentin e instalimit te Kases Fiskale, dhe per pasoje nuk leshon deftese tatimoe per shitjet e kryera.

Ne zbatim te nenit 47, 54, te Ligjit nr.9920/2008 “Per Procedurat Tatimore ne R.Sh” I ndryshuar, si dhe te Udhezimit te Ministrit te Financave me nr.24 dt.02.09.2008 te dale ne zbatim te tij, tatimpaguesi ka detyrimin ligjor per leshimin e kuponit tatimor per cdo transakcion i cili nuk paguhet nepermjet bankes dhe ne mungese te “kuponit” tatimor leshon “deftese tatimore”, konkretisht ne ligj percaktohet:

47. Dokumentimi dhe mbajtja e të dhënave nga tatimpaguesit e biznesit të vogël

“47.1.3 Personi i tatueshëm shitës me pakice, subjekt i taksës vendore mbi biznesin e vogël dhe i tatimit mbi te ardhurat, për çdo shitje ne njësitë e shitjes me pakice, te kryer për individë konsumatore finale, është i detyruar te lëshojë kupon tatimor me arke regjistruese dhe ne mungese te saj dëftesë tatimore.”

Neni 54 Kuponi tatimor

"54.3 Personat e tatueshëm që shesin mallra për konsum final apo ofrojnë shërbime, në njësi të përhershme të hapura për publikun duhet të instalojnë pajisje fiskale dhe të lëshojnë kuponë tatimorë. Kuponi tatimor lëshohet në dy kopje, një nga të cilat është kopje letër që i jepet klientit konsumator të mallrave apo shërbimeve të blera dhe tjetra i mbetet vete personit të tatueshëm në shiritin e kontrollit të arkës regjistruese. Kuponi tatimor është dokumenti nëpërmjet të cilit realizohet transparenca e duhur në marrëdhëniet e çdo biznesi me klientët e tij.

Për personat e tatueshëm, të cilët kryejnë furnizime të shërbimeve të natyrës bar-kafe, restorant, mensa, ku konsumohen pije dhe ushqime, lëshimi i kuponit tatimor duhet të bëhet në të njëjtin moment me furnizimin e porosisë së klientit.

54.5 Dëftesa tatimore është e detyruar të lëshohet edhe në çdo rast tjetër që arkat regjistruese apo pajisjet e tjera fiskale, për çfarëdo arsye qofte, nuk janë në gjendje pune. Dëftesa tatimore lëshohet në dy kopje, një nga të cilat i jepet klientit konsumator të mallrave apo shërbimeve të blera dhe tjetra mbetet në bllokun e vete personit të tatueshëm."

Në bazë të detyrimit ligjor të mesiperm, në rast të moszbatimit të ligjit për lëshimin e defteses tatimore, tatimpaguesi penalizohet conform nenit 122 pika b e ligjit nr. 9920/2008 "Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", në të cilin percaktohet:

Neni 122 "Kundërvajtjet administrative në përdorimin e pajisjeve fiskale, për lëshimin e kuponave fiskalë e të biletave"

1. Tatimpaguesi, person juridik ose fizik, tregtar, dënohet në rast se:

"b) nuk lëshon kupon tatimor për qarkullimin e realizuar të mallrave apo të shërbimeve, për çdo rast konstatimi:

i) për kontrollin e parë, me gjobë, në masën 200 000 (dyqind mijë) lekë, për tatimpaguesit e regjistruar si subjekte të tatimit mbi fitimin, dhe gjobë, në masën 50000 (pesedhjetë mijë) lekë, për tatimpaguesit e tjerë;"

dh) nuk mban kontrollin e gjurmës së kuponit tatimor në mjedisin e ofrimit të mallrave apo të shërbimeve, me gjobë në masën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë;

Pretendimet e tij subjekti nuk i ka bazuar as në ligj dhe as në prova shkresore, në asnjë moment në kerkese padi subjekti nuk argumenton se ku konsiston parregullsia e akteve Administrative. Subjekti kundërshton Njoftim Vleresimin me nr.25410 dt.14.12.2015, duke pene I pasqarte se çfare kerkon konkretisht.

Vlen për tu theksuar fakti se Njoftim Vleresimi nr.25410 dt.14.12.2015, është në përputhje me nenin 106 e në vijim të Kodit të Procedurave Administrative, për vlefshmerinë e akteve dhe nuk ka bazë ligjore për kundërshtimin e tij, subjekti nuk i argumenton ligjerisht pretendimet e tij, kështu me Kodin e Procedurave Administrative në nenin 118, percaktohen rastet se kur Aktet Administrative janë relativisht të pavlefshme:

Neni 118 Aktet administrative relativisht të pavlefshme

“1. Aktet administrative do te quhen relativisht te pavlefshme, ne kuptimin e ketij Kodi, kur ato jane nxjerre ne kundershtrim me ligjin, por megjithate nuk jane absolutisht te pavlefshme”

Ndersa ne nenin nr.7 te Ligjit Per Kundravajtjet Administrative percaktohet:

Neni 7 Kompetenca për konstatimin dhe shqyrtimin e kundërvajtjes

“1. Kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm”

Keshtu ne nenin nr.2 te ligjit “Per Procedurat Tatimore”, percaktohet se Administrata tatimore eshte pergjegjse per zbatimin e ketij ligji.

Kontrolli I ushtruar ne subjektin “Shpresa Guri” eshte ne perputhej me nenin 80 te Ligjit nr.9920/2008 dhe te UMF nr.24 dt.02.09.2008 “Per Procedurat Tatimore”, ne te cilin percaktohet:

80. Kontrolli tatimor

“80.1.1 Objektivi i kontrollit tatimor është sigurimi i plotësismit të detyrimeve tatimore nga ana e tatimpaguesve në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi, nëpërmjet zbulimit dhe parandalimit të shmangieve tatimore dhe evazionit fiskal.

80.3 Kontrollet tatimore janë:

c) Verifikimet ne vend. Këto verifikime te shkurtra synojnë zbulimin ne kohe te shkeljeve qe kane lidhje me regjistrimin e personave te tatueshëm (identifikimin e personave te paregjistruar), me përdorimin e pajisjeve fiskale, me përdorimin e pullave fiskale ne mallrat e akcizës, me dokumentimin e mallrave ne ruajtje, përdorim dhe transport, me dokumentimin e shitjeve dhe lëshimin faturave tatimore, etj. Këto verifikime kryhen pa njoftimin paraprak te personave te tatueshëm, por vetëm nëpërmjet prezantimit ne momentin e verifikimit, te dokumentit personal te verifikuesit dhe urdhrin e ditës, te lëshuar nga drejtuesi i drejtorisë se kontrollit për verifikime ne vend.”

Ndersa Njoftim Vleresimi me nr.25410 dt.14.12.2015 eshte ne perputhje me nent 68, 70 te Ligjit nr.9920/2008 “Per Procedurat Tatimore ne R.Sh” I ndryshuar, ne te cilet percaktohet:

Neni 68 Vlerësimi tatimor

“1. Vlerësimi tatimor:

- a) është llogaritja e detyrimit tatimor të tatimpaguesit nga administrata tatimore; 5. Administrata tatimore vlerëson detyrimin tatimor të tatimpaguesit, në përputhje me dispozitat e legjislacionit përkatës. Vlerësimi bazohet në:*

- a) informacionin, që përmban deklarata tatimore e tatimpaguesit;
b) rezultatet e një kontrolli, në përputhje me kreun X të këtij ligji;

Drejtoria Rajonale Tatimore nuk është në kundërshtim me ligjin në nxjerrjen e Njoftimit Vleresimit Nr. 25410 dt.14.12.2015, pasi në nenin nr.70 të ligjit "Per Procedurat Tatimore" përcaktohet e drejta e Administratës Tatimore Per nxjerrjen e Njoftimit Vleresimit.

Neni 70 E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor
"1. Drejtoria rajonale tatimore nxjerr njoftimin e vlerësimit tatimor për tatimpaguesit e regjistruar në administratën tatimore qendrore."

Gjithashtu pretendimi I subjektit që ka qenë I paisur me "Deftese Tatimore" dhe se ka lëshuar "Deftese Tatimore" për shitjet e kryera nuk qëndron pasi referuar provave shkresore të administruar pranë DRT Fier, subjekti Shpres Guri ka kryer pagesën për terheqjen e "Deftesës Tatimore" në datën 14.09.2015, date në të cilën është bërë edhe terheqja e blloqut të "deftesës tatimore", e vertetuar kjo me "Flete Daljen" me nr.1050 dt.14.09.2015 ku vertetohet terheqja e "bllokut të deftesës tatimore" me nr. Serial 2884801 dt.2884812. Nderkohe që Akt KOnstatimi nr.serial 0529613 dhe Procesverbali me nr. Serial 0179160, mbajnë datën 13.09.2015.

Subjekti Shpresa Guri, me shumë mundësi me "Deftesat Tatimore" të terhequra në datën 14.09.2015, për të justifikuar Akt Padinë, mund të ketë bërë shitje me date të mëparshme, duke bërë kështu shtremberim të fakteve dhe rrethanave, duke mashtruar me dashje Gjykatën dhe duke akuduar për parregullsi të veprimeve nga ana e Inspektoreve të Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier.

Vlen për tu theksuar se objekti I padisë "Kundershtim Njoftim Vleresimi per Detyrimet nr.25410 dt.14.12.2015 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier, vetëm për gjohjen në vlerën 50.000 leke, lene në fuqi me Vendimin nr.42336/1 dt.12.02.2016 të Drejtorisë së Apelitit Tatimor" është një objekt I cili nuk legjitimohet të ngrihet në kuptim të nenit nr.17 të ligjit nr.49/2012 "Per Organizimin dhe Funkcionimin e Gjykatave Administrative dhe zgjidhjen e moamarrveshjeve administrative" dhe në kuptim të neneve nr.31/32, të Kodit të Procedurave Civile.

Zgjidhja ligjore

Gjykata në lidhje me barrën e provës, ka për referencë nenin 35 të ligjit me nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrvëshjeve administrative"-Barra e provës në të cilin citohet se : "1. Organi publik ka detyrimin të provojë ligjshmërinë e aktit administrativ, kontratës administrative dhe të veprimit tjetër administrativ, të

nxjerrë jo me kërkesë të paditësit, si dhe faktet që ai ka parashtruar dhe ka vënë në themel të veprimtarisë së kundërshtuar në gjykatë.

Duke vlerësuar në tërësi rrethanat faktike të provuara në gjykim nëpërmjet provave shkresore, thëniet dhe pohimet e palëve ndërgjyqëse, të çmuara në përputhje me nenet 10,11,12, 29, 213, 214, 246 e vijues dhe 253 e vijues të KPrC dhe mbështetjen ligjore të padisë, si dhe duke referuar në hapësirën ligjore që krijon neni 16 i KPrC sipas të cilit “Gjykata zgjidh mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, që janë të detyrueshme të zbatohen prej saj. Ajo bën një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen pa u lidhur me përcaktimet që mund të propozojnë palët”, arrin në konkluzionin se padia duhet rrezuar për arsyet si më poshtë vijon:

Nga verifikimi i provave materiale të ndodhura pranë Drejtorisë rajonale Tatimore Fier, rezulton se akti Administrativ Njoftim Vlerësim nr. 25410 dt.14.12.2015 është tersisht ligjor, konform formes dhe procedures se kerkuar nga ligji procedural dhe ai material.

Kundershtimi i subjektit në lidhje me Aktin Administrativ të sipercituar nuk ka baze ligjore pasi Akt –Konstatim nr. Serial 0529613 dt.13.09.2015 dhe Proces –Verbali i Gjebes me nr.serial 0179160 dt.13.09.2015 janë teresisht conform ligjit, keshtu kontrolli I ushtruar ne tatimpaguesin Shpresa Guri, nga inspektoret e DRT Fier, eshte bere ne baze te Urdherit te Punes me nr.12618 dt.13.09.2015. Ne akt konststatim thuhet se subjekti ka kryer pagesen per instalimin e paisjes fiskale ne daten 29.08.2015 por nuk eshte I paisur me Deftese Tatimore, dokumenti I cili zvendeson kuponin tatimor per shitjet me leke ne dore, deri ne momentin e instalimit te Kases Fiskale., dhe per pasoje nuk leshon deftese tatimoe per shitjet e kryera.

Ne zbatim te nenit 47, 54, te Ligjit nr.9920/2008 “Per Procedurat Tatimore ne R.Sh” I ndryshuar, si dhe te Udhezimit te Ministrisë te Financave me nr.24 dt.02.09.2008 te dale ne zbatim te tij, tatimpaguesi ka detyrimin ligjor per leshimin e kuponit tatimor per cdo transakcion i cili nuk paguhet nepermjet bankes dhe ne mungese te “kuponit” tatimor leshon “deftese tatimore”, konkretisht ne ligj percaktohet:

47. Dokumentimi dhe mbajtja e të dhënave nga tatimpaguesit e biznesit të vogël

“47.1.3 Personi i tatueshëm shitës me pakice, subjekt i taksës vendore mbi biznesin e vogël dhe i tatimit mbi të ardhurat, për çdo shitje në njësitë e shitjes me pakice, të kryer për individë konsumatore finale, është i detyruar të lëshojë kupon tatimor me arke regjistruese dhe në mungese të saj dëftesë tatimore.”

Neni 54 Kuponit tatimor

“54.3 Personat e tatueshëm që shesin mallra për konsum final apo ofrojnë shërbime, në njësi të përhershme të hapura për publikun duhet të instalojnë pajisje fiskale dhe të lëshojnë kuponë tatimorë. Kuponit tatimor lëshohet në dy kopje, një nga të cilat është kopje letër që i jepet klientit konsumator të mallrave apo shërbimeve të blera dhe tjetra i mbetet vetë personit të tatueshëm në

shiritin e kontrollit të arkës regjistruese. Kuponi tatimor është dokumenti nëpërmjet të cilit realizohet transparenca e duhur në marrëdhëniet e çdo biznesi me klientët e tij.

Për personat e tatueshëm, të cilët kryejnë furnizime të shërbimeve të natyrës bar-kafe, restorant, mensa, ku konsumohen pije dhe ushqime, lëshimi i kuponit tatimor duhet të bëhet në të njëjtin moment me furnizimin e porosisë së klientit.

54.5 Dëftesa tatimore është e detyruar të lëshohet edhe në çdo rast tjetër që arkat regjistruese apo pajisjet e tjera fiskale, për çfarëdo arsye qofte, nuk janë në gjendje pune. Dëftesa tatimore lëshohet në dy kopje, një nga të cilat i jepet klientit konsumator të mallrave apo shërbimeve të blera dhe tjetra mbetet në bllokun e vete personit të tatueshëm.”

Ne baze të detyrimit ligjor të mesiperm, në rast të moszbatimit të ligjit për lëshimin e deftesës tatimore, tatimpaguesi penalizohet conform nenit 122 pika b e ligjit nr. 9920/2008 “Per procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, në të cilin percaktohet:

Sa me sipër në Ligjin 9920 Dt.19/05/2008 "Per Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" I ndryshuar neni 55, pika 1 1. Tatimpaguesit, që kryejnë qarkullimin e mallrave dhe të shërbimeve, për të cilat pagesat nuk kryhen nëpërmjet bankes, janë të detyruar të instalojnë dhe të përdorin sistemin fiskal, nëpërmjet përdorimit të pajisjeve fiskale, për regjistrimin e pagesave me para në dorë dhe për lëshimin, në mënyrë të detyrueshme, të kuponit tatimor. Ndalohet mbajtja apo përdorimi i pajisjeve fiskale dhe sistemeve të monitorimit të qarkullimit, të ndryshme nga ato të percaktuara në këtë ligj apo aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji

Megjithatë në një situatë të mungesës së kases fiskale ligji e ka të percaktuar qatë se duhet të zëvendësohet për efekt të provueshmerisë së shërbimit kundrejt klientit me deftesë tatimore e cila terhiqet pranë D.R.Tatimeve. Mungesa e saj konsiderohet njëlloj sikurse në mungesë të kases fiskale.

Neni 122 “Kundërvajtjet administrative në përdorimin e pajisjeve fiskale, për lëshimin e kuponave fiskalë e të biletave”

1. Tatimpaguesi, person juridik ose fizik, tregtar, dënohet në rast se:

“b) nuk lëshon kupon tatimor për qarkullimin e realizuar të mallrave apo të shërbimeve, për çdo rast konstatimi:

i) për kontrollin e parë, me gjobë, në masën 200 000 (dyqind mijë) lekë, për tatimpaguesit e regjistruar si subjekte të tatimit mbi fitimin, dhe gjobë, në masën 50000 (pesedhjetë mijë) lekë, për tatimpaguesit e tjerë;”

dh) nuk mban kontrollin e gjurmës së kuponit tatimor në mjedisin e ofrimit të mallrave apo të shërbimeve, me gjobë në masën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë;

Pretendimet e tij subjekti nuk i ka bazuar as në ligj dhe as në prova shkresore, në asnjë moment në kërkesë pasi subjekti nuk argumenton se ku konsiston parregullsia e akteve Administrative. Subjekti kundërshton Njoftim Vleresimin me nr.25410 dt.14.12.2015, duke pene I pasqartë se çfare kërkon konkretisht.

Vlen për tu theksuar fakti se Njoftim Vleresimi nr.25410 dt.14.12.2015, është në përputhje me nenet 106 e në vijim të Kodit Te Procedurave Administrative, për vlefshmerinë e akteve dhe nuk

ka baze ligjore per kundershkrimin e tij, subjekti nuk i argumenton ligjerisht pretendimet e tij, keshtu me Kodin e Procedurave Administrative ne nenin 118, percaktohen rastet se kur Aktet Administrative jane relativisht te pavlefshme:

Neni 118 Aktet administrative relativisht te pavlefshme

"1. Aktet administrative do te quhen relativisht te pavlefshme, ne kuptimin e ketij Kodi, kur ato jane nxjerre ne kundershkrim me ligjin, por megjithate nuk jane absolutisht te pavlefshme"

Ndersa ne nenin nr.7 te Ligjit Per Kundravajtjet Administrative percaktohet:

Neni 7 Kompetenca për konstatimin dhe shqyrtimin e kundërvajtjes

"1. Kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm"

Keshtu ne nenin nr.2 te ligjit "Per Procedurat Tatimore", percaktohet se Administrata tatimore eshte pergjegjse per zbatimin e ketij ligji.

Sipas Udhezimit nr. 16. dt. 03.05.2010, " Per administrimin dhe dokumentimin e procedurave te pajisjeve fiskale", pika 19. Perdorimi i deftesave tatimore ne rastet e mosfunksionimit te perkohshem te pajisjeve fiskale, percaktohet se: "Ne rastet e mosfunksionimit te perkohshem te pajisjeve fiskale, te parashikuara ne vendimin e Keshillit te Ministrave, tatimpaguesit jane te detyruar te perdorin deftesen tatimore per cdo shitje me pakice qe realizojne. Blloku me deftesa tatimore do te furnizohet nga drejtorite rajonale tatimore dhe do te jete me nr serial (modeli bashkangjitur udhezimit)".

Gjithashtu ne V.K.M nr. 781, dt. 14.11.2007, (i ndryshuar), pika 13.2, percaktohet se " Shoqerit e autorizuar per furnizimin dhe mirembajtjen e sistemeve dhe pajisjeve fiskale duhet te sigurojne stafin teknik per mirembajtjen e tyre. Gjate mirembajtjes, tekniket e shoqerive te autorizuar mbajne procesverbal, ne dy kopje, ku pasqyrohen te dhenat rreth tatimpaguesit, i cili ka pasur ankesa per parregullesi te pajisjeve fiskale. Procesverbalet i bashkangjiten librit te mirembajtjes.

Mirembajtja e pajisjes fiskale, perfshire edhe mirembajtjen e memories fiskale, nuk mund te zgjase me shume se dy dite nga data e paraqitjes se ankeses per parregullsi. Per sa mesiper.

Nga sa mesiper lidhur me detyrimin per te instaluar dhe perdorur pajisjet fiskale, referuar Ligjit 9920 date 19.05.2008, "Per Procedurat Tatimore", neni 55 " Detyrimi per perdorimin e pajisjeve fiskale", thekson: 1 .Tatimpaguesit, qe kryejne qarkullimin e mallrave dhe te sherbimeve, per te cilat pagesat nuk kryhen nepermjet bankes, jane te detyruar te fusin dhe te perdorin sistemin fiskal, nepermjet perdorimit te pajisjeve fiskale, per regjistrimin e pagesave me para ne dore dhe per leshimin, ne menyre te detyrueshme, te kuponit tatimor, si dhe Vendimi i Keshillit te Ministrave nr.781, dt. 14.11.2007 pika 1 thuhet: "Te gjitha tatimpaguesit e shitjeve me pakice, qe shesin mallra apo ofrojne sherbime ne mjedise, apo njesi te perhershme te hapura per publikun, instalojne pajisje fiskale dhe leshojne kupone tatimor per cdo transakcion".

Kontrolli I ushtruar në subjektin "Shpresa Guri" është në përputhje me nenin 80 të Ligjit nr.9920/2008 dhe të UMF nr.24 dt.02.09.2008 "Per Procedurat Tatimore", në të cilin përcaktohet:

80. Kontrolli tatimor

"80.1.1 Objektivi i kontrollit tatimor është sigurimi i plotësisë të detyrimeve tatimore nga ana e tatimpaguesve në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi, nëpërmjet zbulimit dhe parandalimit të shmangieve tatimore dhe evazionit fiskal.

80.3 Kontrollat tatimore janë:

c) Verifikimet në vend. Këto verifikime të shkurtra synojnë zbulimin në kohë të shkeljeve që kanë lidhje me regjistrimin e personave të tatueshëm (identifikimin e personave të peregjistruar), me përdorimin e pajisjeve fiskale, me përdorimin e pullave fiskale në mallrat e akcizës, me dokumentimin e mallrave në ruajtje, përdorim dhe transport, me dokumentimin e shitjeve dhe lëshimin e faturave tatimore, etj. Këto verifikime kryhen pa njoftimin paraprak të personave të tatueshëm, por vetëm nëpërmjet prezantimit në momentin e verifikimit, të dokumentit personal të verifikuesit dhe urdhrin e ditës, të lëshuar nga drejtuesi i drejtorisë së kontrollit për verifikime në vend."

Ndërsa Njoftim Vlerësimi me nr.25410 dt.14.12.2015 është në përputhje me nent 68, 70 të Ligjit nr.9920/2008 "Per Procedurat Tatimore në R.Sh" I ndryshuar, në të cilin përcaktohet:

Neni 68 Vlerësimi tatimor

"1. Vlerësimi tatimor:

- a) është llogaritja e detyrimit tatimor të tatimpaguesit nga administrata tatimore;
5. Administrata tatimore vlerëson detyrimin tatimor të tatimpaguesit, në përputhje me dispozitat e legjislacionit përkatës. Vlerësimi bazohet në:
 - a) informacionin, që përmban deklarata tatimore e tatimpaguesit;
 - b) rezultatet e një kontrolli, në përputhje me kreun X të këtij ligji;

Drejtorja Rajonale Tatimore nuk është në kundërshtim me ligjin në nxjerrjen e Njoftim Vlerësimi Nr. 25410 dt.14.12.2015, pasi në nenin nr.70 të ligjit "Per Procedurat Tatimore" përcaktohet e drejta e Administratës Tatimore për nxjerrjen e Njoftim Vlerësimi.

Neni 70 E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimi tatimor

"1. Drejtorja rajonale tatimore nxjerr njoftimin e vlerësimi tatimor për tatimpaguesit e regjistruar në administratën tatimore qendrore."

Gjithashtu pretendimi I subjektiti qe ka qene I paisur me "Deftese Tatimore" dhe se ka leshuar "Deftese Tatimore" per shitjet e kryera nuk qendron pasi referuar provave shkresore te administruar prane DRT Fier, subjekti Shpres Guri ka kryer pagesen per terheqjen e "Defteses Tatimore" ne daten 14.09.2015, date ne te cilen eshte bere edhe terheqja e blloqut te "defteses tatimore", e vertetuar kjo me "Flete Daljen" me nr.1050 dt.14.09.2015 ku vertetohet terheqja e "bllokut te defteses tatimore" me nr. Serial 2884801 dt.2884812. Nderkohe qe Akt KONstatimi nr.serial 0529613 dhe Procesverbali me nr. Serial 0179160, mbajne daten 13.09.2015.

Subjekti Shpresa Guri, me shume mundesi me "Deftesat Tatimore" te terhequra ne daten 14.09.2015, per te justifikuar Akt Padine, mund te kete bere shitje me date te meparshem, duke bere keshtu shtremberim te fakteve dhe rrethanave, duke mashtruar me dashje Gjykatën dhe duke akuduar per parregullsi te veprimeve nga ana e Inspektoreve te Drejtorise Rajonale Tatimore Fier.

Gjykata çmon se aktet administrative objekt gjykimi nuk vijnë në kundërshtim me procedurën e përcaktuar në ligj duke i bërë këto në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Administrative si dhe të Ligjit për Kundravajtjet administrative. Gjykata nuk gjen shkak ligjor per shfuqizimin e këtyre akteve administrative te palës se paditur.

Sa me sipër, gjykata krijoi bindjen se kërkesa padia subjekti Shpresa Guri është e pa mbështetur në ligj dhe ne prova dhe, si rrjedhojë ajo duhet rrezuar.

Vlen te theksohet se ku vendim ne mbeshtetje te nenit 45 te ligjit nr.49/2012 « Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative » nuk lejohet ankim ndaj vendimeve përfundimtare të gjykatës administrative për padi me objekt:

...

b) kundërshtimin e aktit administrativ që përmban detyrim në të holla, me vlerë më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi;

Rezulton se ne rastin konkret masa e dënimit administrativ kundrejt paditet ka qene ne masën 50.000 leke dhe për rrjedhoje ndaj këtij vendimi nuk mund te kryhet ankim

PER KETO ARSYE :

Gjykata, bazuar ne nenin 126 dhe 310 te K.Pr.Civile dhe nenet 40, 42 te ligjit me nr.49/2012 nr.49/2012 "Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" :

V E N D O S I:

-Rrëzimin e padisë.

-Shpenzimet gjyqësore palës paditëse.

-Ky vendim ne reference te nenit 45/ç te ligjit nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" është i formës se prere.

U Shpall, ne Vlore sot me date 31.03.2016

SEKRETAR
Anil Rista




GJYQTARI
Astrit Shema



SHPENEZIMET GJYQESORE

Takse padie 3000 leke
Takse njoftimi 200 lek
Takse avokatie leke
Shuma totale 32000 leke



Vendimi mori formë të pranë
Sot më datë 31 03 2016
KANCJLARE Tatyola NYFTARI